



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORI

Nr. 581 Prot.

Gjirokastrë më, 01.04.2026

VENDIM

Nr. 04, datë 01, 04, 2026

PËR
PASQYRIMIN NË SISTEMIN RASH (PITAGORA) TË LËNDËVE DHE
REZULTATEVE TË NJOHURA (EKUIVALENTUARA)

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 38, Statutit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, neni 72 dhe neni 92, Rregullores së Studimeve në UGj-së neni 37, 50 dhe 51, Senati Akademik në mbledhjen e të datës 25.03.2026,

VENDOSI :

1. Në çdo rast kur një studenti i njihen (ekuivalentohen) lëndë dhe rezultate nga studime të mëparshme, këto lëndë nuk i nënshtrohen provimit në programin përkatës.
2. Për lëndët e njohura, njihet dhe pasqyrohet e njëjta notë e përfituar në studimet e mëparshme, sipas vendimit përkatës të njohjes.
3. Pasqyrimi i lëndëve dhe notave në sistemin RASH (Pitagora) kryhet pas regjistrimit dhe aktivizimit të studentit në programin përkatës.
4. Hedhja e këtyre të dhënave në sistem kryhet nga sekretaritetë mësimore, bazuar në dokumentacionin zyrtar të njohjes (ekuivalentimit).
5. Ky vendim zbatohet për të gjitha rastet e njohjes së studimeve, përfshirë:
 - ndjekjen e një programi të dytë studimi;
 - transferimet e studentëve;
 - rifillimet e studimeve;
 - si dhe çdo rast tjetër të parashikuar në rregulloren e studimeve.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi njësitë kryesore, njësitë bazë, sekretaritetë mësimore dhe strukturat përkatëse administrative.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë.

KRYETARI
PROF. DR JAHO CANA

